



PRANIMJE:

ACCEPTED ON: 26.02.2025

PRIMJERO:

Nr No.Br. 02/31



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PROCESVERBAL

i mbledhjes së -VI- (gjashtë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja u mbajt me datë: 16.12.2024 dhe filloi në ora: 10:40.

Në mbledhje morë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Drejtori për Ekonomi, Financa dhe Buxhet Blerim Thaçi, antarët e komisionit: Rukije Bytyqi, Veton Zogaj, Gentianë Hoti, Sadik Vranezi, Këshilltar ligjor i Kuvendit Muharrem Morina, përfaqësuesi nga OSBE dhe zyra për informim.

Mungon: Arlindë Rudi (PDK).

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -VI- (gjashtë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent në mbledhje jemi 5 anëtarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. Kërkoj që tek pika e parë të hiqet nga rendi i ditës procesverbali i mbledhjes së pestë pasi nuk është gati dhe pika e tretë pasi kjo pikë është rekomanduar për kuvend në mbledhjen e kaluar. Kush është për largimin e këtyre dy pikave?

Me vota unanime të 5 anëtarëve, këto dy pika largohen nga rendi i ditës.

Kush është për këtë rend të ditës me plotësimet e bëra?

Me 4 vota për, dhe një abstenim, Kryesuesi konstatoi se u miratua ky:

Rend i ditës:

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dytë urgjente e mbajtur me datë 27.09.2024.
- 2.Shqyrtimi i Raportit të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-shtator 2024.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/429 datë:29.10.2024.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i listës së pronave të paluajtshme komunës.
- 5.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.
- 6.Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për Transparencë në Komunën e Malishevës.
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme.

Pika e parë

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dytë urgjente e mbajtur me datë 27.09.2024

Argjend Thaçi: Kush është për miratimin e procesverbalit?

Me vota unanime të 5 anëtarëve kalon kjo pikë.

Pika e dytë

2. Shqyrtimi i Raportit të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-shtator 2024.

Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa): Plani i realizimit të të hyrave vetanake për periudhën janar shtator 2024, është të hyra të rregullta janë 1,416,192.43E, si total për këtë periudhë buxheti kap shumën 20,816.046.24E. Në këtë periudhë kemi pasur tejkalim të të hyrave.

Alukimi i buxhetit janar-shtator kap shumën 18,766,465.41E. Realizimi i buxhetit për këtë periudhë kap vlerën e njëjtë 94%.

Kurse përqindja e tërësishme e buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë është 90.15%.

Sipas buxhetit për vitin fiskal 2024, nga të hyrat vetanake janë planifikuar të mbledhen 916,849.00E, dhe tejkalim 522,491.00E, që shuma totale e THV për periudhën janar shtator 2024 është 1,473,094.74E.

Neve na ka ndihmuar shumë tejkalimi i të hyrave për këtë periudhë, sepse kemi mbuluar shumë obligime sepse kemi pasur dëmtim të buxhetit në lëndët përmbartimore të shujtave. Nga pasqyrat që i kam nxjerrur para një jave për periudhën janar nëntor kemi arritur ti realizojmë 2,400.000.00E të hyra.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Urdhëro, Vetoni!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Drejtor, një Raport nuk kemi arritur me diskutu në Kuvend, për shkak të lëshimit të sallës nga Grupi Nisma dhe pastaj ai Raport nuk erdhi asnjëherë në kuvend dhe ka mbetur pa u diskutu.

Mirë është që qytetarët dhe bizneset po i kryejnë obligimet e tyre dhe kjo po ndikon me i rrit të hyrat vetanake në komunën tonë, mirëpo në disa kategori prapë po vazhdon me u përcjellë, sepse ka rënie në raport me vitin 2023 për periudhat e njëta kohore.

Tek certifikatat e kurorëzimit në vitin 2024 janë 229.60E, ndërsa në vitin 2023 janë 3,220.00E, këtu është një rënie.

Te certifikatat e tjera në këtë vit kemi 5000E më pak.

Taksa tjera administrative kemi 10.000.00E më pak.

Licenca për afarizëm ka rritje. Taksa për legalizim në vitin 2023 kanë qenë 1.964E ndërsa në vitin 2024 janë zero. Këto objektet që ndërtohen a marrin leje nga Drejtoria e Urbanizmit kur përfundojnë a legalizohen.

Pranimi Teknik i lokaleve nuk kemi të hyra. Gjopa nga gjykata kemi rënie për 4.000E

Muharrem Morina (Këshilltar ligjor i Kuvendit): Legalizimi ka kuptim tjetër nga ajo që ti po alodon, sepse ato që po thua ti janë leje ndërtimore, ndërsa legalizimi është kryesisht ndërtesat që janë ndërtuar para vitit 2018, ato janë ndërtime ilegale.

Blerim Thaçi (Drejtori për Buxhet e Financa): Kur e kemi sjellur ngarkesën e taksave për bizneset vetëm qka po na ngarkojnë më shumë në buxhet, unë disa biznese i kisha liruar sepse po ka telashe dhe në grumbullim të mjeteve. Te tatimi në pronë kemi pasur tejkalim.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Kush është për rekomandim për kuvend Raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-shtator 2024?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Pika e tretë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/429 datë:29.10.2024.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Bëhet fjalë për Raportin e punës së Komisionit vlerësues me rastin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike përmes thirrjes së interesit publik konform vendimit të kuvendit nr.02/121 datë:08.03.2024. Urdhëro, Muharrem!

Muharrem Morina (Këshilltar ligjor i Kuvendit): Me vendimin e Kuvendit nr.02/121 datë:08.03.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike. Në kuadër të këtij vendimi janë marrur dhe dy vendime të tjera, formimi i Komisionit për dhënien në shfrytëzim dhe Komisioni i ankesave. Me kohë janë proceduar në Ministrinë e Pushtetit Lokal, dhe Ministria në afatin ligjor ka kthyer përgjigjen dhe ligjshmërinë vetëm për komisionin e ankesave, ndërsa për Komisionin vlerësues me vendimin për shërbim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë nuk e ka kthyer. Dy muaj kemi pritur përgjigje mirëpo nuk kanë kthyer dhe ne si komision kemi vazhduar në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në të cilën konfirmimi i ligjshmërisë është i obliguar në rastin konkret nga Ministria me dhënë pozitiv, negative apo në rishqyrtim. Ne e kemi pasur thirrjen publike për të cilën e kërkon dhe Ligji për dhënien në shfrytëzim të pronave publike, shfrytëzim afatgjatë, kjo thirrje ka qenë e hapur 15 ditë. Pas përfundimit të procedurave ne kemi pasur vetëm një ofertë, e kemi shqyrtuar, i kemi analizuar të gjitha kriteret dhe në fund kemi përgaditur raportin përfundimtarë të punës së Komisionit dhe e kemi dërguar në Kuvend.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Pse janë shumë prona në një raport, unë mendoj që Komisioni është dashur ti ndaj, sepse ndonjëherë pronë mundesh me penalizu që është në interes të komunës me e dhënë , e një pronë tjetër nuk është në interes. Unë nuk e kam të qartë si si do e votojmë këtë.

Problematic për mu mbetet ky njoftimi publik i pronës që është kjo e B-Famis, a është kjo te Sahat Kulla, kjo është problematike dhe mendoj që ne si subjekt politik kemi me kundërshtu edhe në kuvend po edhe në instancat e tjera ligjore, sepse për mua bënë shkelje. Kur ka filluar ky projekti i ndërtimit të sheshit, komuna është zotuar që ka me qenë hapësirë publike sepse parku është hapësirë publike, i cili tani është duke u rindërtuar. Kritikën dhe atëherë i kemi dhënë për formën dhe mënyrën, mirëpo jemi pajtuar në një mënyrë që me u bërë investime dhe pse kosoto ka qenë e lartë, mirëpo tani me i'a dhënë pronat publike një ndërtuesi privat i cili ka me ndërtuar banesa, objekte afariste është uzurpim i pronës publike dhe ne kemi me kundërshtuar. Për këtë arsye ndoshta po i penalizon dhe shumë prona tjera që janë në interes që i kishim votuar me i dhënë në shfrytëzim. Me i rrënuar dy objekte, njëra është rrënuar dhe tani dhe sahat kulla e cila nuk ka asnjë studim për të, 350,000E ku kanë mbetur para publike, duhet me ditë kush ka marr aso vendime dhe në anën tjetër me i'a dhënë privatit me ndërtuar banesa dhe me bërë marrëveshje private me njerëz, siç ka bërë me lagjen Hoti dhe Minolli dhe me të tjera. Muharrem, nuk është dashur si komision me kaq lehtësi me sjellë këtë.

Muharrem Morina (Këshilltar ligjor i Kuvendit): Konceptin që e ke ndërtuar për Komisionin e ke të gabuar sepse ne i kemi kryer procedurat, nuk e kemi dhënë në shfrytëzim. Vendimin për me dhënë atë pronë e ka marr Kuvendi, ne i kemi kryer procedurat dhe kuvendit nuk i kemi rekomanduar asgjë. Ky

është raport i punës, procedurat që i kemi zhvillu nga a deri zh. Nëse Kuvendi e miraton raportin dhe e voton ofertën që e ka bërë operatori atëherë vendimarrjen e merr Kuvendi dhe nëse e refuzon prapë është Kuvendi.

Veton Zogaj (anëtar i VV): Unë e kam të qarë procedurën dhe nuk thash që e keni dhënë. Këtë ofertën që e ka bërë B-Famis ju si Komision keni mundur me sjellë si kërkesë ose si raport të veçantë. Thirrja publike për shprehje të interesit sipas vendimit 02/121 datë: 08.03.2024, ma sqaro këtë.

Muharrem Morina (Këshilltar ligjor i Kuvendit): Është kërkesa e kryetarit, vendimi i asambles, formimi i komisionit, këtu janë të bashkangjitura komplet.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Kush është për rekomandim për Kuvend kërkesën nr.01/429 datë:29.10.2024?

Për: 3

Kundër: 1

Abstenim: 1

Pika e katërt

4.Shqyrtimi dhe miratimi i listës së pronave të paluajtshme komunës.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Unë e kisha shty nga rendi i ditës këtë pikë, pasi nuk është prezent drejtori, me na dhënë sqarime për një numër të madh të pronave ku janë.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Nëse kjo listë nuk miratohet deri me 31 dhjetor të këtij viti, në vitin tjetër nuk mundemi me dhënë në shfrytëzim asnjë pronë në lidhje me këtë listë.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Veton, për 200 prona është e pamundur me i sjellë fletat poseduese.

Veton Zogaj (anëtar nga VV): 9 prona janë vetëm në Lladroc që nuk e di as ku janë.

Gentianë Hoti (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Unë mendoj që kjo list duhet të kalojë në Kuvend dhe nuk mundet drejtori me i sjellë për 200 prona fletat poseduese.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Kush është për rekomandim për kuvend listën e pronave?

Për: 3

Kundër: 1

Abstenim: 1

Pika e pestë

5.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Urdhëro, Muharrem!

Muharrem Morina (Këshilltar ligjor i Kuvendit): Është një Plan i cili rëndësinë më të madhe e ka tek performanca e komunës në lidhje me nivelin qendror. Unë nuk kam qenë me përcjellë në komitet mirëpo Plani si dokument ka mangësi të mëdha. Naseri është kryetar i komisionit, unë i kam dhënë disa vërejtje

që disa janë hequr. Vërejtja ime kryesore ka qenë Plani 2024-2029 dhe propozimi im ka qenë 2025-2030 sepse nuk mundemi me bërë ne plan për vitin 2024 kur ne jemi në fund të vitit 2024. Janë marr shënime nga dokumentet tjera që kanë qenë jo profesionale ku njëra prej tyre ka qenë ku flitet për ujërat mbitoksore, ku thuhet që komuna e Malishevës ka dy liqene- liqeni Mirushes dhe Liqeni I Banjës, dhe vërejtja ime ka qenë që në Banjë nuk ka liqen. Si draft ndoshta është mirë me kaluar për shkak të performancës, ndërsa për anën profesionale unë kam pasur vërejtje.

Gentinë Hoti (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): A mundemi me kërkuar me heq këtë dhe me sjellë me ndryshime në kuvend.

Muharrem Morina (Këshilltar ligjor i Kuvendit): Ky është vetëm draft dhe në kuvend mundemi me ndryshuar 2025-2030.

Rukije Bytyqi (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Për mbetjet e fermave, nuk po e shohë asgjë.

Muharrem Morina (Këshilltar ligjor i Kuvendit): Kjo nuk i trajton ato.

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Ne mundemi me ja kaluar në Kuvend, me zotimin që i bënë plotësim ndryshimet. Nëse vjen kështu siç është, ne nuk e votojmë në kuvend.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Ne e votojmë për Kuvend me plotësim ndryshimet e kërkuara në KPF-ë. Kush është për rekomandim për Kuvend?
Me vota unanime votohet për kuvend.

Pika e gjashtë

6.Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për Transparencë në Komunën e Malishevës.

Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit): Urdhëro, Izet!

Izet Shala (anëtar i Komisionit për Rregulloren): Tek draft Rregullorja për Transparencë është e bashkangjitur dhe Plani i veprimit dhe strategjia për komunitet. Procedurat kanë filluar në vitin 2024 dhe do jetë 2025-2029. Është kërkuar që me dhënë këtu futja e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Te transparenca në territor të komunës së Malishevës për vitin 2023-2024 në këtë periudhë është 97-98%, që ka shënuar rritje, sidomos te qasja e dokumenteve publike

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale kjo nuk lejohet vetëm në këto kategorit psh te kërkesat për ndihma shëndetësore.

Izet Shala: Dhe tek lejet ndërtimore, numri leternjoftimit, numri i telefonit.

Muharrem Morina (Këshilltar ligjor i Kuvendit): Kodi i procedurës penale e parasheh që do të ishte shkelje e të drejtave të njeriut dhe vepër penale për personat që ushtrojnë aktivitet pozitiv politike dhe publike nëse publikohet numri personal, emri prindërit dhe vendbanimi, dhe jo emri dhe mbiemri

Izet Shala: Më e ndjeshme është dhe tek kamerat ingjizuese, qoftë dhe brenda institucioneve publike dhe jashtë publike. Në shkolla janë instaluar kamera dhe ka keqpërdorim psh x drejtori nga Korqa permes tel shikon se qka bëjnë gjatë pauzës, gjë që nuk ka të drejt sepse është personi adekuat që e shikon.

Gentian Hoti (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Ti po thua, Drejtori, nuk ka të drejtë me i shikuar kamerat.

Izet Shala: Dhe nëse është drejtori aty ai duhet ta ketë një komision të posaqëm brenda shkollës dhe jo vetë me i shikuar.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Kush është për rekomandim për Kuvend draft-Rregullores për Transparencë në Komunën e Malishevës?
Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Kalojmë tek pika shqyrtimi i kërkesave. I kemi tre kërkesa për ndërrim destinim. Kërkesa nr06/299, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe pronë ka pranuar kërkesën nr.06/218 datë:28.10.2021 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore e paraqitur nga Luan Karaqica, nga fshati Balincë. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresës së lëndës, të punuar nga ,gjeodet,i/e licencuar Suzanë Hoti me nr lic 47, për parcelat e sipër cekura për të cilën është paraqitur kërkesa. Paluajtshmëria P-723100001-00146-2, Zona kadastrale Balincë, me shfrytëzim aktual mal i Arë e Klasit 7, pronë e Luani Consulting SHPK, nga Balinca, e cila gjendet në zonën Kadastrale Balincë. Sipërfaqja totale e kësaj paluajtshmërie është 45m, ku dhe kërkohet të bëhet ndërrim destinimi në tokën ndërtimore në sipërfaqe totale prej 45m.

Kërkesa tjetër është nga Mani Premium shpk, zona kadastrale Mleqan sipërfaqja totale e kësaj paluajtshmërie është 4490m, ndërsa sipërfaqja që kërkohet të bëhet ndërrim destinimi në tokë ndërtimore është S=2000m.

Gnetianë Hoti (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Unë mendoj që këto kërkesa të këtyre natyrave të na vinë në email që ti shqyrtojm. A janë këto lëndë të kompletuara?

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Nga Drejtoria për Gjeodezi na kanë ardhur. Kërkesa tjetër është nga Valon Garaj i cili kërkon ndërrim destinim të pronës së paluajtshme nga toka bujqësore në tokë ndërtimore. Kush është për rekomandim për kuvend këto tre kërkesa?

Me vota unanime të 5 anëtarëve këto kërkesa rekomandohen për Kuvend.

Kërkesa tjetër është nga KKSB, i cili ka kërkuar një vendim nga Kuvendi që të ndahen mjetet financiare për këtë Komitet.

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Kemi lënë shumë punë keq dhe kemi ardhur në Komitete dhe prapë nuk paguhen.

Muharrem Morina (Këshilltar ligjor i Kuvendit): Personat që nuk janë pjesë e administratës, ata munden me i marr mjetet, meditet që ja lejon ligji, por duhet procedurën me ndjek. Personat që janë zyrtar të Komunës ligji ja ndalon.

Veton Zogaj (anëtar nga VV): Trupat që i themelon Kuvendi për punët specifike, kur e bënë një Komision të tillë duhet ta paguash. Unë jam pro që kjo kërkesë të shkojë në Kuvend.

Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit): Kush është që kërkesa nga KKSB të rekomandohet për Kuvend?
Me vota unanime, kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.


Kemi një kërkesën të cilën e kemi përfunduar në kuvend rreth oborrit të Ambullantes, sepse ne këtë

kërkesë ka ardhur nga zyra e kryetarit dhe e kemi përfunduar. Kush është për që kjo kërkesë të refuzohet?
Me vota unanime të 5 anëtarëve, kjo kërkesë refuzohet.

Mbledhja përfundoi në ora:12:10.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

